



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 526/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bekim Ibishit, rruga “Sevdi dhe Selami Musliu nr.102” në Skenderaj, paraqitur kundër komisionerëve në Skenderaj, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 26.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL A.nr 526/2017 e datës 25.10.2017, e parashtruar nga Bekim Ibishit, rruga “Sevdi dhe Selami Musliu nr.102” në Skenderaj, paraqitur kundër komisionerëve në Skenderaj, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-së, ka pranuar një ankesë me datë 25.10.2017, nga Bekim Ibishi, rruga “Sevdi dhe Selami Musliu nr.102” në Skenderaj në të cilën ankesë nuk ka parashtruar asnjë pretendim ankimorë lidhur me shkeljen e supozuar zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me mungesën e votave në vendvotime, për faktin se shkeljet që ndërliken me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së ankueses Bekim Ibishi, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL Anr. 526/2017 më datën 26.10.2017



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.